


# DIALOGU KOSOVË - SERBI GJATË VITIT 2018 NË KUVENDIN E KOSOVËS

Mars, 2019



# **DIALOGU KOSOVË - SERBI GJATË VITIT 2018 NË KUVENDIN E KOSOVËS**

---

Mars, 2019

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Layout and design: **envinion**

**Shënim:** Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", i financuar nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>6</b>
<b>1. DIALOGU KOSOVË-SERBI NË SEANCAT E KUVENDIT .....</b>	<b>7</b>
<b>2. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE E DIALOGUT KOSOVË – SERBI .....</b>	<b>14</b>
2.1 Pyetjet Parlamentare .....	14
2.2 Interpelancat.....	17
2.3 Debatet Parlamentare.....	17
2.4 Rezolutat .....	19
<b>3. DIALOGU NË KOMISIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS.....</b>	<b>20</b>
3.1 Takimet koordinuese në mes të komisioneve parlamentare.....	22
3.2 Mbikëqyrja në terren e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit .....	23
<b>4. REKOMANDIME .....</b>	<b>24</b>
<b>SHTOJCË – PUNA E KOMISIONEVE PARLAMENTARE NË RAPORT ME DIALOGUN .....</b>	<b>25</b>
Komisioni për Buxhet dhe Financa .....	25
Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim .....	26
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit .....	26
Komisioni për Integritet Evropian .....	27
Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike .....	29
Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi .....	31
Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.....	31
Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor .....	32
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale .....	33
Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media .....	33
Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.....	34
Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.....	35
Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike .....	36
Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.....	36



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**K**uvendi i Kosovës në sesionin pranveror dhe vjeshtor të vitit 2018, në përgjithësi ka luajtur një rol reaktiv ndaj zhvillimeve politike lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

Diskutimet e zhvilluara në Kuvendin e Kosovës, gjatë kësaj periudhe të legjislaturës së gjashtë, reflektuan qëndrimet e ndryshme të partive parlamentare rreth formatit të përfaqësimit të Kosovës në procesin e dialogut – rolit të institucioneve kushtetuese, temave të cilat duhet të jenë pjesë e dialogut, vijave të kuqe të shtetit të Kosovës në këtë proces, si dhe marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut të deritanishëm.

Nëse dialogu Kosovë-Serbi shihet nga pikëvështrimi i funksionimit të Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2018, atëherë mund të konkludohet se në sesionin pranveror çështjet lidhur me dialogun janë trajtuar kryesisht në komisionet parlamentare dhe në suaza të mekanizmave për mbikëqyrje parlamentare. Ndërsa në sesionin vjeshtor dialogu ka qenë temë diskutimi kryesisht në seanca plenare dhe më pak prezente në mbledhjet e komisioneve parlamentare, ndërsa deputetët nuk kanë ushtruar kontroll të mirëfilltë parlamentar mbi këtë çështje.

Gjatë sesionit pranveror deputetët e Kuvendit të Kosovës, në trajtimin e çështjes së dialogut Kosovë-Serbi fokus më të madh i kanë dhënë çështjeve që ndërlidhen me zbatimin e marrëveshjeve tashmë të arritura në kuadër të këtij procesi si dhe diskutimeve se kush duhet të udhëheq me procesin e dialogut – çështja e cila u trajtuar dhe në session pasardhës. Mungesa e konsensusit në mes partive parlamentare kishte sjell dhe reagimin e shoqërisë civile të cilët kërkuan nga deputetët që e ardhmja e dialogut të jetë çështje diskutimi në Kuvendit e Kosovës. Në sesioni vjeshtor, deputetët e Kuvendit gjatë trajtimit të dialogut Kosovë-Serbi vëmendje i kushtuan çështjeve që ndërlidhen me integritetin territorial të Kosovës tezës së Presidentit Thaçi rreth 'koorigjimit të kufinjëve' dhe iniciativave të partive parlamentare për parandalimin e këtij skenari si dhe emërimin e një delegacioni shtetëror të Kosovës për dialogun me Serbinë.

Gjithsesi, vlen të theksohet që veçanërisht gjatë sesionit vjeshtor, dialogu Kosovë-Serbi ndikoi drejtpërdrejt në funksionimin e punës së Kuvendit. Kjo pasi që, si rezultat i pikëpamjeve të ndryshme mbi këtë proces, u thelluan ndasitë dhe përçarjet ndërmjet pozitës dhe opozitës. Kjo rezultoi në pamundësimin e shumicës së nevojshme për zhvillimin e punimeve të Kuvendit, si pasojë e bojkoteve të partive në





Komisionet parlamentare që kanë diskutuar më së shumti temat e ndërlidhura me dialogun janë Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

pozitë dhe atyre në opozitë, të cilat nuk mbështetën iniciativat e ndërmarra nga njëra-tjetra lidhur me të ardhmen e dialogut Kosovë-Serbi. Pika të rendit të ditës u trajtuan në seanca plenare me muaj të tërë në mungesë të konsensusit politik të partive parlamentare.

Dialogu Kosovë-Serbi ka qenë pjesë e rendit të ditës në vetëm 10 nga 42 seanca të mbajtura gjatë kësaj periudhe, ndërsa si temë është diskutuar në 50% të seancave. Ndërsa, tri rezoluta, nga 15 sa votoi Kuvendi në këtë periudhë, kanë të bëjnë me çështjen e dialogut. Më 15 dhjetor, Kuvendi votoi rezolutën për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, çështje e cila ishte diskutuar përgjatë vitit 2018.

Deputetët e Kuvendit parashtruan vetëm 9 pyetje (3% nga numri i përgjithshëm i pyetjeve parlamentare) për përfaqësuesit e Qeverisë lidhur me çështje të dialogut. Përgjatë sesionit vjeshtor, nuk është parashtruar asnjë pyetje parlamentare dhe nuk është iniciuar asnjë interpelancë lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Kjo mund të konsiderohet si një indikator për rënie të dukshme të nivelit të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës të deputetëve ndaj ekzekutivit, në raport me procesin e dialogut.

Në anën tjetër, komisionet parlamentare nuk i kanë kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së dialogut Kosovë-Serbi. Gjatë vitit 2018, çështjet që ndërlidhen me dialogun janë diskutuar në 12% të mbledhjeve, ndërsa në vetëm 3% të këtyre mbledhjeve, çështjet e dialogut kanë qenë pjesë e rendit të ditës. Kjo dëshmon për gatishmëri të ulët të komisioneve për të trajtuar çështjen e dialogut, pavarësisht faktit që përgjatë vitit 2018, çështja e të ardhmes së dialogut ka qenë një ndër temat qendrore të cilat kanë ndikuar zhvillimet politike në Kosovë.

Komisionet parlamentare që kanë diskutuar më së shumti temat e ndërlidhura me dialogun janë Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Me mbështetjen e KDI-së, janë organizuar dy takime koordinuese në mes komisioneve parlamentare të cilat kanë synuar ofrimin e një platformë diskutimi, bashkërendimi dhe dakordimi në mes komisioneve parlamentare rreth rolit të tyre në procesin e dialogut Kosovë-Serbi, ndërtimin e bashkëpunimit të ndërsjellë për monitorimin, mbikëqyrjen, pjesëmarrjen dhe transparencën e këtij procesi.



# HYRJE

Ky raport vjetor paraqet punën e Kuvendit në trajtimin e çështjes së procesit të dialogut Kosovë-Serbi gjatë sesionit pranveror dhe atë vjeshtor të vitit 2018, i cili filloi me 15 janar 2018 dhe përfundoi më 28 dhjetor 2018.

Raporti fillon në pjesën e parë me ofrimin e një pasqyre e përgjithshme mbi trajtimin që i është bërë çështjes së dialogut në seancat plenare të Kuvendit të Kosovës, duke përfshirë këtu pikat e rendit të ditës rreth dialogut dhe diskutimin e temave të ndërlidhura me këtë proces.

Në pjesën e dytë të raportit, trajtohet mbikëqyrja parlamentare e dialogut Kosovë-Serbi, përkatësisht mekanizmat që deputetët kanë në dispozicion për mbikëqyrjen e ekzekutivit, si pyetjet parlamentare, interpelancat, debatet parlamentare dhe rezolutat e aprovuara në Kuvend lidhur me këtë temë.

Në pjesën e tretë të raportit, ofrohen të dhëna mbi punën e secilit komision parlamentar në trajtimin e çështjeve të ndërlidhura me dialogun. Në këtë pjesë vihet në pah ushtrimi i mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit dhe agjencive përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjeve si dhe trajtimin që Komisionet Parlamentare i kanë bërë të ardhmes së këtij procesi.

Të dhënat e këtij raporti janë të bazuara nga monitorimi i punës së Kuvendit nga ana e KDI-së, bazuar në të dhënat publike të qasshme në faqen zyrtare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilat janë të reflektuara edhe në platformën Vota Ime<sup>1</sup>.

Raporti ka për qëllim rritjen e transparencës së punës së Kuvendit në mbikëqyrjen e procesit të dialogut Kosovë-Serbi, dhe me anë të kësaj transparence rritjen e llogaridhënies dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në këtë proces.

---

1 Për më shumë, shih platformën: <http://votaimo.org/Public/DialogActivity/Detail/198>





# 1. DIALOGU KOSOVË-SERBI NË SEANCAT E KUVENDIT

Kuvendi i Kosovës, gjatë vitit 2018 ka trajtuar procesin e dialogut në gjysmën e seancave të mbajtura. Konkretisht, deputetët e Kuvendit kanë diskutuar rreth dialogut në 21 nga 42 seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe. Në 10 nga këto seanca, tema e dialogut ka qenë pjesë e rendit të ditës, ndërsa në 11 seanca tjera, dialogu është ngritur si çështje jashtë rendit të ditës.<sup>2</sup>

Temat e dialogut Kosovë-Serbi janë diskutuar më shumë gjatë sesionit vjeshtor, në krahasim me atë pranveror të vitit 2018. Kjo ka ardhur si rezultat i intensifikimit të deklaratave në opinionin publik se nevojitet një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, ku Kosova është gati të bëjë kompromise, si dhe nevojën për krijimin e një grupi gjithëpërfshirës për negociim.<sup>3</sup>

Mirëpo, përpos trajtimit të kësaj teme në nivel diskutimesh apo debatesh publike, ajo çfarë e ka karakterizuar këtë proces është mungesa e vendimmarrjes në Kuvend. Lidhur me këtë fenomen, pra, trajtimin e procesit të dialogut nëpër studio televizive apo konferenca për media, ka pasur reagime

nga shoqëria civile, sidomos nga KDI, duke kërkuar që arena e diskutimeve lidhur me këtë çështje të jetë, në rend të parë, Kuvendi i Kosovës. Në anën tjetër, gjatë sesionit vjeshtor, mungesa e vendimmarrjes në seancat plenare të Kuvendit ka ardhur si reflektim i zhvillimeve politike në vend, marrë

parasysh bllokimin e punës së Kuvendit nëpërmjet pamundësisimit të kuorimit për mbajtjen e seancave nga ana e subjekteve opozitare, si dhe bllokimin e seancave të njëjës apo palës tjetër, për shkak të mospërbushjes së kërkesave të caktuara.

Temat më të diskutuara gjatë seancave të Kuvendit kanë qenë çështja e idesë së korigjimit të kufijve e iniciuar nga Presidenti Hashim Thaçi, nevoja për kalimin e një rezolute për fazën e re të

dialogut, si dhe krijimi i një ekipi negociator për dialogun. Temat tjera të diskutimit lidhur me dialogun kanë qenë çështja e energjisë, taksa 100% ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, personat e zhdukur, Marrëveshja për Telekomunikacion, mungesa e transparencës në dialog, Marrëveshja e Parë e Parimeve e vitit 2013, dhe të tjera. (Shih Tabelën 1.1)



Temat e dialogut Kosovë-Serbi janë diskutuar më shumë gjatë sesionit vjeshtor, në krahasim me atë pranveror të vitit 2018.

2 Duke marrë parasysh edhe vazhdimet e seancave, del se çështjet lidhur me dialogun janë diskutuar në 36 seanca, prej të cilave në 23 seanca çështjet e dialogut kanë pika të rendit të ditës, ndërsa në 13 seanca tjera çështjet që ndërlidhen me dialogun janë diskutuar jashtë rendit të ditës.

3 Për më shumë, shih lajmin: <http://www.arbresh.info/lajmet/ne-fazen-finale-te-dialogut-kosova-te-kete-ekip-gjithperفشires/> [Qasur më 24 gusht, 2018]







2018

01

02

03

25.01.2018

SEANCA:  
**Plenare**
**Diskutim**

Marrëveshja për Energjinë;  
Marrëveshja për Telekomun;  
Asociacioni i Komunave  
serbe;

08.02.2018

SEANCA:  
**Plenare**
**Diskutim**

Asociacioni i Komunave me  
Shumicë Serbe

18.02.2018

SEANCA:  
**Solemne**
**Diskutim**

Dialogu me Serbinë në përgjithësi

23.02.2018

SEANCA:  
**E jashtëzakonshme**
**Diskutim**

Kontestet kufitare me Serbinë dhe  
demarkacioni; Mungesa e trans-  
parencës në dialog; Fusnota; Aso-  
ciacioni i Komunave me shumicë  
serbe; Marrëveshja e 19 prillit

02.03.2018

SEANCA:  
**Plenare**
**Diskutim**

Kërkesë për përfshirjen e çështjes së të  
zhdukurve në dialog

14.03.2018

SEANCA:  
**Vazhdim i seancës plenare**
**Diskutim**

Lidhur me përfshirjen e opozitës në dialog

16.03.2018

SEANCA:  
**Plenare**
**Diskutim**

Marrëveshja për Energji dhe KOSTT

1

**interpelancë  
për dialogun**

3

**debate parlamentare  
për dialogun**

3

**rezoluta lidhur  
për dialogun**

**Tabela 1.1:** Dialogu në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 (sesioni pranveror dhe vjeshtor)

04

04.04.2018

SEANCA:

**E jashtëzakonshme**
 **Diskutim**

Procesi i dialogut me Serbinë në përgjithësi;

16.04.2018

SEANCA:

**Plenare**
 **Rend Dite**

Shqyrtimi i Raportit të operatorit të sistemit, transmissio-  
it dhe tregut-KOSTT; Interpelanca e Kryeministrit të Re-  
publikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, sipas kërkesës  
së Grupit Parlamentar të LDK-së, në lidhje me vendimin e  
Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare në  
shumën prej një milion euro për KOSTT-in për mbulimin  
e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër  
komunave në veri të Kosovës

17.04.2017

SEANCA:

**Vazhdim i seancës plenare**
 **Rend Dite**

Shqyrtimi i Raportit të operatorit të sistemit, transmissio-  
it dhe tregut-KOSTT

26.04.2018

SEANCA:

**Plenare**
 **Rend Dite**

Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush  
Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së, në  
lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 05.03.2018,  
për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro  
për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me  
energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës

27.04.2018

SEANCA:

**E veçantë**
 **Rend Dite**

Debat parlamentar për personat e pagjetur

01.06.2018

SEANCA:

## Vazhdim i seancës plenare

### Diskutim

Ndarja e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës

06.06.2018

SEANCA:

## vazhdim i seancës plenare

### Rend Dite

Miratimi i Rezolutës me rekomandimet nga interpelanca e kryeministrit Haradinaj, sipas kërkesës së GP LDK-së, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 05.03.2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in

26.07.2018

SEANCA:

## Vazhdim i seancës plenare

### Rend Dite

Debat parlamentar për dialogun me Serbinë

30.07.2018

SEANCA:

## vazhdim i seancës plenare

### Rend Dite

Vazhdim i Debatit parlamentar për dialogun me Serbinë

04.09.2018

SEANCA:

## E jashtëzakonshme

### Rend Dite

Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e Ekipit Negociator për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

04.09.2018

SEANCA:

## Plenare

### Rend Dite

Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. (Në mungesë të kuorumit nuk është hedhur në votim vendimi i Qeverisë për ekipin negociator dhe nuk është mbajtur seanca e kërkuar nga opozita për idenë e korrigjimit të kufijve )

13.09.2018

SEANCA:

## Plenare

### Rend Dite

Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjimit të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë

**Tabela 1.1:** Dialogu në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 (sesioni pranveror dhe vjeshtor)

09

10

14.09.2018

SEANCA:

### Vazhdim i seancës plenare

#### Rend Dite

Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë (Në mungesë të kuorimit nuk është hedhur në votim projekt rezoluta e propozuar nga PSD)

20.09.2018

SEANCA:

### vazhdim i seancës plenare

#### Rend Dite

Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë; Propozim-rezoluta e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga shtatë (7) deputetë të GP të AAK-së, në lidhje me çështjen liberalizimi i vizave para dialogut

20.09.2018

SEANCA:

### vazhdim i seancës plenare

#### Rend Dite

Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë (Propozim rezoluta nuk u hodh në votim)

15.10.2018

SEANCA:

### Vazhdim i seancës plenare

#### Rend Dite

Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë (Me kërkesë të deputetit Visar Ymeri, u hoq nga rendi i ditës votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë)

31.10.2018

SEANCA:

### E jashtëzakonshme

#### Rend Dite

Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korigjim të kufijve" në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë/ Propozim rezoluta e LDK-LVV- Alternativa

31.10.2018

SEANCA:

### vazhdim i seancës së jashtëzakonshme

#### Rend Dite

Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë (Votimi i Rezolutes se propozuar nga LDK-LVV- Alternativa u shty për seancën tjetër)

01.11.2018

SEANCA:

## vazhdim i seancës së jashtëzakonshme

### Rend Dite

Votimi i rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. (Në mungesë korumi, Kuvendi nuk arriti të miratojë asnjë nga pikat e parapara)

01.11.2018

SEANCA:

## vazhdim i seancës plenare

### Rend Dite

Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë (Rezoluta e LDK-LVV-Alternativa u hodh në votim por nuk kaloi)

02.11.2018

SEANCA:

## Seancë plenare

### Rend Dite

Votimi i Propozim-rezolutës së PSD-së nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë (Nuk u hodh në votim)

23.11.2018

SEANCA:

## vazhdim i seancës plenare

### Rend Dite

Votimi i Propozim-rezolutës së PSD-së nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë; Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e shkëmbimit të territoreve apo korrigjimit të kufijve në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Propozim rezoluta e PSD-së u tërhoq nga rendi i ditës nga propozuesi ndërsa për rezolutën e LDK-LVV-Alternativa nuk pati kuorum)

23.11.2018

SEANCA:

## Plenare

### Rend Dite

Taksa prej 100% ndaj produkteve të prodhuara në Serbi dhe Bosnje e Hercegovin

**Tabela 1.1:** Dialogu në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 (sesioni pranveror dhe vjeshtor)

12

04.12.2018

SEANCA:

**E jashtëzakonshme**

 **Diskutim**

Dialogu me Serbinë në përgjithësi

06.12.2018

SEANCA:

**Plenare**

 **Diskutim**

Dialogu me Serbinë në përgjithësi

15.12.2018

SEANCA:

**E jashtëzakonshme**

 **Rend Dite**

Kërkesa e 42 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme për miratimin e Projekt-rezolutës mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë (U miratua kjo Rezolutë)

21.12.2018

SEANCA:

 **Rend Dite**

Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë; Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë (Me kërkesë të PSD-së, në cilësi të iniciuesit, u hoq nga rendi i ditës votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë)

26.12.2018

SEANCA:

**Plenare**

 **Diskutim**

Presidenti Thaçi përmendi dialogun në përgjithësi gjatë adresimit të tij vjetor në Kuvendin e Kosovës



## 2. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE E DIALOGUT KOSOVË – SERBI

Duke qenë një nga kompetencat kryesore të Kuvendit, mbikëqyrja parlamentare paraqet formën më klasike të kontrollit ndaj ekzekutivit, që mund të ushtrohet nëpërmjet mekanizmave të shumtë, duke përfshirë pyetjet parlamentare, interpelancat apo debatet parlamentare. Në këtë pjesë, do të trajtohet performanca e Kuvendit në mbikëqyrjen parlamentare në raport me dialogun Kosovë-Serbi, gjegjësisht mekanizmat të cilat janë përdorur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës përgjatë vitit 2018, në dy sesionet e tij.

### 2.1 Pyetjet Parlamentare

Përmes pyetjeve parlamentare, deputetët kanë në dispozicion mekanizmin e kërkim-llogaridhënies nga kryeministri apo ministrat lidhur me aktivitetet dhe efikasitetin e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve të caktuara. Marrë parasysh numrin e seancave të mbajtura, dhe përcaktimeve në Rregullore që secili deputet mund të parashtrrojë deri në dy pyetje parlamentare, vetëm një pjesë e vogël e deputetëve, respektivisht gjashtë prej tyre, kanë ushtruar të drejtën e tyre për t'a mbajtur qeverinë llogaridhënëse lidhur me procesin e dialogut.

Gjatë vitit 2018, 55 nga 120 deputetët e Kuvendit kanë parashtruar gjithsej 275 pyetje parlamentare, prej të cilave përgjigje janë dhënë vetëm në 179 prej tyre (65%). Nga ky
















numër i përgjithshëm i pyetjeve parlamentare, vetëm nëntë prej tyre ishin në lidhje me dialogun, prej të cilave tetë kanë marrë përgjigje. Shumica e pyetjeve, përkatësisht gjashtë sosh, janë parashtruar nga deputetët e LDK-së. Kurse, Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate kanë parashtruar vetëm nga një pyetje. (Shih Tabelën 1.2) Në raport me dialogun Kosovë-Serbi, çështja që ka zgjuar më shumë interes për deputetët, e që është reflektuar në tematikën e pyetjeve parlamentare, ndërlidhet me Marrëveshjen për Energjinë, gjegjësisht faturimin e konsumatorëve për energjinë e shpenzuar në katër komunat në veri dhe mjetet e ndara nga Qeveria për mbulimin e harxhimeve në atë pjesë të vendit<sup>4</sup>. Lidhur me këtë çështje janë parashtruar katër nga gjithsej nëntë pyetjet parlamentare lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

Dy pyetje janë parashtruar lidhur me të drejtat e qytetarëve të Luginës së Preshevës, dy të tjera lidhur me përbërjen e grupit negociator dhe udhëheqjen e procesit nga presidenti Thaçi, kurse një pyetje është parashtruar lidhur me masat që do t'i ndërmarrë Qeveria e Kosovës në planin e politikës së jashtme, për t'iu kundërpërgjigjur fushatës së Serbisë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës, dhe ndalimit të sportistëve kosovarë<sup>5</sup>. Në përgjithësi, këto pyetje kanë reflektuar diskutimet e ngritura në diskursin publik, që ka mbizotëruar gjatë periudhës në fjalë.

4 Nder faktorët tjerë që kanë ndikuar në ngritjen dhe diskutimin e kësaj çështje janë miratimi i vendimit nga ana e Qeverisë, sipas të cilit janë ndarë mjete buxhetore për mbulimin e faturave të shpenzimit të energjisë elektrike për qytetarët në veri, publikimi i një raporti nga ana e Avokatit të Popullit, ku konstatohen shkelje të të drejtave të qytetarëve, si dhe vendimi i gjykatës përkatëse për këtë temë.













5 Për më shumë, shih lajmin: <https://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-serbia-sports/4385277.html> [Qasur më 24 gusht, 2018]



	PARASHTRUESI	DREJTUAR PËR	PËRGJIGJUR	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
25.01.2018	 Haxhi Shala - NSD	 <b>Flamur Sefaj</b> Ministër i Punëve të Brendshme		Dokumentet për banorët e Luginës së Preshevës
25.01.2018	 Mirjeta Kalludra - LDK	 <b>Valdrin Lluka</b> Ministër i Zhvillimit Ekonomik		Faturat e ujit dhe energjisë të pjesës Veriore
25.01.2018	 Mirjeta Kalludra - LDK	 <b>Valdrin Lluka</b> Ministër i Zhvillimit Ekonomik		Faturat e ujit dhe energjisë të pjesës Veriore
25.01.2018	 Mirjeta Kalludra - LDK	 <b>Valdrin Lluka</b> Ministër i Zhvillimit Ekonomik		Faturat e ujit dhe energjisë të pjesës Veriore
16.03.2018	 Imet Rrahmani - LDK	 <b>Ramush Haradinaj</b> Kryeministër		Dokumentet e shtetësisë për banorët e shpërngulur të Luginës së Preshevës

**Tabela 1.2:** Pyetjet Parlamentare rreth Dialogut gjatë vitit 2018 (sesioni pranveror dhe vjeshtor)



	PARASHTRUESI	DREJTUAR PËR	PËRGJIGJUR	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
03.05.2018	 Driton Selmanaj - LDK	 <b>Ramush Haradinaj</b> Kryeministër		Mandati i Qeverisë në Dialog
03.05.2018	 Driton Selmanaj - LDK	 <b>Ramush Haradinaj</b> Kryeministër		Negociatat e Presidentit për territor
03.05.2018	 Ismajl Kurteshi - LVV	 <b>Ramush Haradinaj</b> Kryeministër		Faturat e energjisë të pjesës veriore
17.05.2018	 Blerta Deliu - Kodra - PDK	 <b>Behgjet Pacolli</b> Ministër i Punëve të Jashtme		Fushata e lobimit të Serbisë kundër Kosovës

**Tabela 1.2:** Pyetjet Parlamentare rreth Dialogut gjatë vitit 2018 (sesioni pranveror dhe vjeshtor)

GJATË VITIT 2018,



**55**

DEPUTETË TË  
KUVENDIT

kanë parashtruar gjithsej

**275**  
PYETJE



**9**

PYETJE  
LIDHUR ME  
DIALOGUN

**1**

Pyetje nuk ka  
marrë përgjigje

**8**

Pyetje që kanë marr  
përgjigje



Kryeministri Ramush Haradinaj i prin listës së anëtarëve të kabinetit qeveritar ndaj të cilëve janë parashtruar më së shumti pyetje parlamentare, me katër pyetje, i pasuar nga ministri Valdrin Lluka me tri pyetje, si dhe ministrat Flamur Sefaj dhe Behgjet Pacolli me nga një pyetje. Ministri Pacolli është i vetmi anëtar i kabinetit qeveritar i cili nuk është përgjigjur në pyetjen e parashtruar ndaj tij.

## 2.2 Interpelancat


Përpos pyetjeve parlamentare, mekanizëm tjetër i vlerësuar si efektiv në mbajtjen e ekzekutivit llogaridhënës janë edhe interpelancat parlamentare, të cilat kanë për qëllim iniciimin e një debati më të gjerë dhe gjithëpërfshirës lidhur me tema të caktuara. Sa i përket ushtrimit të këtij mekanizmi në raport me dialogun Kosovë-Serbi, edhe pse Kuvendi ka qenë aktiv në iniciimin e interpelancave në përgjithësi, ato nuk janë ushtruar për mbikëqyrjen e procesin e dialogut. Kjo pasi që, vetëm një interpelancë, nga 13 sosh sa janë mbajtur gjatë vitit 2018, është iniciuar për një temë që ndërlihet me dialogun.


Interpelanca e vetme, që ishte mbajtur më 31 maj të vitit 2018, ishte thirrur nga grupi parlamentar i LDK-së, për kryeministrin Ramush Haradinaj, lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e 1 milion eurove për KOSTT-in<sup>6</sup>, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike për katër komunat në veri të vendit. Gjatë kësaj interpelance, ishin propozuar tri rekomandime, të cilat kërkonin ndaljen e praktikave të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri, gjetjen e një mënyre për t'i shmangur humbjet në veri, si dhe zbritjen e tarifave që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve të cilat kanë paguar me vite të tëra për energjinë e shpenzuar në veri të vendit. Kryeministri Haradinaj kishte akuzuar palën serbe për mosimplementim të Marrëveshjes për Energjinë, dhe sipas tij, në këtë gjendje Serbia fiton rreth 30 milion euro



Në raport me dialogun Kosovë-Serbi, çështja që ka zgjuar më shumë interes për deputetët, e që është reflektuar në tematikën e pyetjeve parlamentare, ndërlihet me Marrëveshjen për Energjinë, gjegjësisht faturimin e konsumatorëve për energjinë e shpenzuar në katër komunat në veri dhe mjetet e ndara nga Qeveria për mbulimin e harxhimeve në atë pjesë të vendit

6 Vendimi i datës 5 mars 2018, për ndarjen e 1 milion eurove për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të vendit, erdhi si rezultat i kërkesës së KOSTT-it – me arsyetimin se këto mjete do të ndihmojnë në sanimin e humbjeve, dhe ruajtjen e funksionalitetit në tregun energjetik. Për më shumë, shih lajmin: <https://www.koha.net/arberi/79205/qeveria-ndan-1-milion-euro-per-ti-furnizuar-me-rryme-komunat-veriore/>. [Qasur më 24 gusht, 2018]





në vit nga Kosova. Pikat e propozuara nuk u hodhën në votim, për shkak të mungesës së kuorumit. Kjo rezolutë u votua në seancën e 6 qershorit 2018 me 57 vota "pro" dhe 16 "kundër"<sup>7</sup>.

## 2.3 Debatet Parlamentare

Sa i përket debateve parlamentare, gjatë vitit 2018, nga gjithsej 19 debate parlamentare sa janë zhvilluar në Kuvendin e Kosovës, vetëm tri prej tyre janë thirrur në lidhje me çështje të cilat ndërlidhen me procesin e dialogut, respektivisht lidhur me personat e pagjetur, angazhimet e Presidentit për "korrigjimin e kufijve", si dhe procesin e dialogut në përgjithësi.

Nëse bëhet një ndarje e punës së Kuvendit në sesionin pranveror dhe atë vjeshtor, atëherë del se në sesionin pranveror janë mbajtur dy debate parlamentare, një lidhur me personat e pagjetur<sup>8</sup>, ndërsa tjetri lidhur me dialogun me Serbinë në përgjithësi<sup>9</sup>, kurse në sesionin vjeshtor është mbajtur vetëm një debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjimit të kufijve" në kuadër të procesit të dialogut Kosovë

Serbi. Vlen të përmendet se gjatë sesionit vjeshtor, përkatësisht gjatë muajit shtator, një numër i konsiderueshëm i seancave, ku ishte paraparë zhvillimi i diskutimeve mbi dialogun, kanë dështuar si rezultat i mungesës së kuorumit. Kjo ka reflektuar marrëdhëniet e acaruar mes pozitës dhe opozitës përgjatë asaj periudhe, si pasojë e bllokimit të seancave apo nismave të iniciuara nga njëra apo pala tjetër.

Debati parlamentar për personat e zhdukur<sup>10</sup> ishte rasti i parë kur Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme lidhur me një temë që ndërlidhet direkt me procesin e dialogut gjatë vitit 2018. Kjo seancë e veçantë ishte thirrur për nder të javës që u kushtohet personave të zhdukur. Pothuajse të gjitha grupet parlamentare patën qëndrime të njëjta sa i përket kësaj çështje, duke kërkuar që kjo të diskutohet edhe në fazat e ardhshme të dialogut me Serbinë. Sidoqoftë, votimi i rezolutës në këtë seancë dështoi për shkak të mungesës së kuorumit. Rezoluta u votua në mbledhjen e datës 3 maj 2018.<sup>11</sup> Kjo rezolutë, ndër tjerash, kërkon zbardhjen e plotë të fatit të personave të zhdukur<sup>12</sup>, kushtëzimin e Serbisë për zbardhjen e kësaj çështje – si parakusht për vazhdimin e dialogut, finalizimin e të gjithë bazës ligjore për personat e zhdukur nga Qeveria e Kosovës, ngritjen e një padie në instanca

7 Për më shumë, shih votimin: <http://votaime.org/Public/PlenarySessions/ViewVotingActivity/367> [Qasur më 12 mars, 2018]


8 Për më shumë, shih transkriptën e mbledhjes së veçantë të Kuvendit të Kosovës, e mbajtur më 27 prill dhe 3 maj të vitit 2018. E qasshme në: [http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans\\_2018\\_04\\_27\\_10\\_7394\\_al.pdf](http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_2018_04_27_10_7394_al.pdf) [Qasur më 16 janar, 2018]

9 Për më shumë, shih transkriptën e mbledhjes së veçantë të Kuvendit të Kosovës, e mbajtur më 23, 26, dhe 30 korrik të vitit 2018. E qasshme në: [http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans\\_s\\_2018\\_07\\_23\\_11\\_7565\\_al.pdf?fbclid=IwAR1u3GypjFPTDqxr98o4VREhd1AVzt-Gy61FLoeC1uklw5M-HJgxbxklgP3Ns](http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2018_07_23_11_7565_al.pdf?fbclid=IwAR1u3GypjFPTDqxr98o4VREhd1AVzt-Gy61FLoeC1uklw5M-HJgxbxklgP3Ns) [Qasur më 16 janar, 2018]

10 Debatit parlamentar për personat e pagjetur ishte iniciuar nga deputetja Saranda Bogujevci dhe Andin Hoti, mbështetur nga 70 deputetë të tjerë. Ky debat është mbajtur më 27 prill të vitit 2018.

11 Nga gjithsej 75 deputetë që morën pjesë në votim, 71 votuan 'për', katër 'kundër' dhe një 'abstenim'.

12 Pika 4 e kësaj rezolute, kërkon në mënyrë eksplicite zbardhjen e fatit të Ukshin Hotit, për shkak të rrethanave të zhdukjes së tij.





# 19 DEBATE PARLAMENTARE



# 3 DEBATE TË CILAT NDËRLIDHEN ME PROCESIN E DIALOGUT

ndërkombëtare kundër Serbisë si përgjegjëse kryesore për personat e zhdukur si dhe hartimin e projektligjit që mundëson gjykimin e të akuzuarve për krime lufte në mungesë.

Kuvendi ka mbajtur edhe një debat tjetër për procesin e dialogut me Serbinë, që ishte iniciuar nga grupi parlamentar i PSD-së gjatë muajit korrik. Në këtë debat parlamentar ishte kërkuar që Kuvendi i Kosovës të jetë institucioni kryesor vendimmarrës për të gjitha çështjet që janë të lidhura me procesin aktual të dialogut me Serbinë. Gjithashtu, ishte ofruar një kornizë të përgjithshme mbi parimet e negocimit, grupin udhëheqës dhe çështje të tjera. Kjo projekt-rezolutë nuk u përkrah nga grupet parlamentare dhe nuk u diskutua më tej pasi që kjo seancë u ndërpre. Në seancën e 30 korrikut, ku mori pjesë edhe kryeministri Haradinaj, u debatua sërish lidhur me projekt-rezolutën në fjalë. Kryeministri ofroi informata mbi mbarëvajtjen e deritanishme të procesit, si dhe sqaroi çështjen e pajtimit me Serbinë, që sipas tij nuk nënkupton në asnjë mënyrë falje të krimeve, duke qenë se kohëve të fundit në publik ishte përmendur ideja e amnistimit të krimeve të kryera gjatë luftës. Në anën tjetër, deputetët prezentë njëzëri kërkuar që të definohen në mënyrë strikte rezultatet që duhet të sjellë dialogu, e që sipas tyre, njohja e Kosovës nga Serbia duhet të ndodhë pashmangshëm. Sidoqoftë, përkundër diskutimeve të hollësishme për këtë çështje, në mungesë kuorumi kjo rezolutë nuk u hodh në votim.

Në sesionin vjeshtor të punës së Kuvendit për këtë vit, ka pasur disa përpjekje për mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës në çështjet e "korrigjimit të

kufijve". Mirëpo, shumica e këtyre përpjekjeve kishin dështuar si rezultat i përplasjeve dhe qëndrimeve diametralisht të kundërta në mes të pozitës dhe opozitës. Në shumicën e këtyre rasteve, debati parlamentar ishte ndërprerë apo shtyrë për një ditë tjetër për shkak të mungesës së kuorunit dhe mospajtueshmërive mbi tekstin e rezolutave përkatëse që do të votoheshin në fund.

Debati i fundit parlamentar që është zhvilluar lidhje me dialogun ishte thirrur nga grupi parlamentar i LDK-së. Ky debat është mbajtur më 31 tetor dhe 1 nëntor të vitit të kaluar, mirëpo rezoluta e propozuar nuk ishte miratuar për shkak të mospjesëmarrjes në votim të deputetëve të pozitës, duke qenë se pikat e propozuara nga këta të fundit nuk ishin marrë parasysh nga propozuesit e rezolutës<sup>13</sup>.

Në këtë debat ishin paraqitur qëndrimet e grupeve parlamentare lidhur me përfshirjen e Presidentit të Kosovës në fazën përfundimtare të dialogut Kosovë-Serbi, gjegjësisht të idesë së tij për korrigjimin e kufirit me Serbinë. Qëndrimet e grupeve parlamentare në pozitë dhe atyre në opozitë (LDK dhe LVV), dallonin lidhur me përmbajtjen që duhej të kishte rezoluta në fjalë, meqenëse opozita kërkonte që rezoluta duhet të përbëhej nga një pikë e vetme që ndalon diskutimet për territorin, derisa pozita kërkonte që rezoluta të përfshinte një gamë më të gjerë të temave, dhe jo vetëm të temës së kufijve.

Grupi parlamentar i LDK-së, gjatë seancës kishte akuzuar Presidentin për shkelje të Kushtetutës së Kosovës dhe qasje kundër shtetësisë së Kosovës, duke cenuar vetë bazamentet

13 Për më shumë, shih transkriptin e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, e mbajtur më 31 tetor dhe 1 nëntor të vitit 2018: [http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans\\_2018\\_10\\_31\\_10\\_7679\\_al.pdf](http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_2018_10_31_10_7679_al.pdf) [Qasur më 22 janar, 2019]



e pavarësisë. Qëndrim të ngjashëm kishte mbajtur edhe grupi parlamentar i LVV-së, të cilët patën vlerësuar se nuk ka nevojë për një fazë të re finale të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, meqë, sipas tyre, kontesti mes dy vendeve kishte marrë fund pas vendimit të GJND-së lidhur me shpalljen e pavarësisë nga ana e Kosovës.

Në anën tjetër, grupet parlamentare të koalicionit qeverisës, me deklaratimet e tyre kishin lënë të kuptohet se nuk do të votonin asnjë rezolutë lidhur me këtë çështje, ndonëse i bënin thirrje subjekteve opozitare që të përfshihen në mënyrë aktive në procesin e dialogut.

Sidoqoftë, e përbashkëta e të gjitha deklaratimeve të grupeve parlamentare gjatë kësaj seance ishte kërkesa për njohje nga ana e Serbisë, si rezultati i paqëndrueshëm që duhet të arrihet në dialog, si dhe përjashtimi i mundësive për ndarje të Kosovës.

Qeveria e Kosovës, gjatë muajit prill kishte miratuar një platformë<sup>14</sup> për fazën e fundit të dialogut me Serbinë.<sup>15</sup> Kjo platformë ishte dërguar për miratim në Kuvend, mirëpo pas kundërshtimeve të ashpra nga grupet parlamentare opozitare, më 5 qershor, kur edhe ishte paraparë zhvillimi i debatit dhe votimi i kësaj platforme, Qeveria kishte tërhequr këtë platformë, me arsyetimin se nevojitet kohë shtesë për ndërtimin e një konsensusi më të gjërë nacional.<sup>16</sup>

## 2.4 Rezolutat

Përgjatë vitit 2018, Kuvendi i Kosovës ka miratuar gjithsej 15 rezoluta, prej të cilave tri rezoluta ishin lidhur me dialogun<sup>17</sup>:

Rezoluta për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, Rezoluta për situatën e krijuar pas vendimit për mbulimin e mjeteve për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunitat në veri, si dhe Rezoluta mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Prej këtyre tri rezolutave, dy të parat janë miratuar gjatë sesionit pranveror, ndërsa tjetra gjatë sesionit vjeshtor. Pothuajse të gjitha rezolutat lidhur me dialogun janë iniciuar nga grupet parlamentare opozitare, me përjashtim të rezolutës për personat e pagjetur, që ishte iniciuar bashkërisht nga dy deputetë nga pozita dhe opozita.

Gjatë sesionit vjeshtor, ka pasur disa tentativa për nxjerrjen e rezolutave lidhur me dialogun, posaçërisht nga subjektet opozitare, të cilat kanë dështuar të votohen si pasojë e mungesës së kuorumit, herë nga bojkotimi i mbledhjeve nga ana e pozitës dhe herë nga opozita.

Rezoluta e vetme e miratuar gjatë sesionit vjeshtor, ishte rezoluta e iniciuar grupi parlamentar i PSD-së, përkrahur nga grupet parlamentare të koalicionit qeverisës, me përjashtim të grupit parlamentar të LS-së. Nëpërmjet kësaj rezolute janë përcaktuar parimet e marrëveshjes eventuale, përkufizimet dhe korniza e dialogut, aktet normative përcjellëse si dhe afatet kohore. Po ashtu, rezoluta rregullon strukturën, mandatin, funksionimin, vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen e Delegacionit Shtetëror, i cili do të përbëhet nga 12 anëtarë<sup>18</sup>. Sa i përket mbikëqyrjes parlamentare, rezoluta parasheh krijimin e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të Dialogut. Rezoluta është miratuar më 15 dhjetor. Në votim morën pjesë 61 deputetë, prej të cilëve 59 votuan 'për', ndërsa dy deputetë tjerë abstenuan<sup>19</sup>.

- 
- 14 Platforma për fazën e fundit të dialogut me Serbinë, që përmban vetëm nëntë pika, parasheh që procesin e dialogut do t'a udhëheqë presidenti Taçi, kurse dialogu duhet të përfundojë me njohje reciproke.
- 15 Për më shumë, shih lajmin: <https://telegrafi.com/platforma-e-qeverise-se-kosoves-per-fazen-e-fundit-te-dialogut-serbine/> [Qasur më 24 gusht, 2018]
- 16 Për më shumë, shih lajmin: <http://rtv21.tv/terhiqet-nga-kuvendi-platforma-per-dialogun-me-serbine/> [Qasur më 24 gusht, 2018]
- 17 Për më shumë, shih: Rezoluta Nr. 06-R-008, miratuar më 5 qershor 2018. E qasshme në: [http://kuvendikosoves.org/common/docs/2018\\_06\\_11\\_Rezoluta%20nr.06-R-008.pdf](http://kuvendikosoves.org/common/docs/2018_06_11_Rezoluta%20nr.06-R-008.pdf) [Qasur më 23 gusht, 2018]  
Rezoluta Nr. 06-R-003, miratuar më 3 maj 2018. E qasshme në: [http://kuvendikosoves.org/common/docs/2018\\_05\\_07\\_Rezolute\\_Nr\\_06\\_R\\_003.pdf](http://kuvendikosoves.org/common/docs/2018_05_07_Rezolute_Nr_06_R_003.pdf) [Qasur më 23 gusht, 2018]  
Rezoluta Nr. 06-R-015, miratuar më 15 dhjetor 2018. E qasshme në: [http://kuvendikosoves.org/common/docs/2018\\_12\\_18\\_Rezoluta%2006-R-015.pdf](http://kuvendikosoves.org/common/docs/2018_12_18_Rezoluta%2006-R-015.pdf) [Qasur më 16 janar, 2018]
- 18 Anëtarët e Delegacionit Shtetëror janë: Shpend Ahmeti dhe Fatmir Limaj (bashkëdrejtues), Enver Hoxhaj, Avni Arifi, Behgjet Pacolli, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Mahir Yağcılar, Dardan Gashi, një anëtar nga shoqëria civile, një përfaqësues i komunitetit boshnjak, si dhe një përfaqësues tjetër nga opozita.
- 19 Për më shumë, shih votimin: <http://votaim.org/Public/PlenarySessions/ViewVotingActivity/650> [Qasur më 12 mars, 2018]



# 3. DIALOGU NË KOMISIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS


Gjatë vitit 2018, 14 komisionet e Kuvendit të Kosovës kanë mbajtur gjithsej 414 mbledhje dhe 23 dëgjime publike, në të cilat janë diskutuar çështje që bien në fushëveprimin e komisioneve respektive, siç janë të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit. Procesi i dialogut Kosovë-Serbi dhe temat e ndërlidhura me këtë proces janë ngritur në 44 mbledhje të komisioneve, ndërsa në 13 prej tyre ato kanë qenë edhe pjesë e rendit të ditës. Nëse përkthehet në përqindje, atëherë del se çështjet lidhur me dialogun janë diskutuar në 10% të mbledhjeve, ndërsa në 3% të mbledhjeve ato kanë qenë pjesë e rendit të ditës. Temat më të diskutuara, të ndërlidhura me këtë proces, kanë qenë zbatimi i marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut si dhe e ardhmja e këtij procesi.

Në kuadër të rolit të tyre mbikëqyrës ndaj qeverisë, komisionet e Kuvendit kanë ftuar pesë ministra të Qeverisë për të raportuar rreth çështjeve lidhur me dialogun. Ndërsa, kjo çështje është ngritur edhe në kuadër të raportimeve të ministrave për tema tjera, në gjithsej 13 mbledhje të komisioneve. Lidhur me Marrëveshjen për Drejtësinë ka raportuar një herë Ministri i Drejtësisë Abelard Tahiri, ndërsa dy herë ka raportuar Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, lidhur me lobimin e Serbisë kundër Kosovës. Ministri i Punëve të Brendshme Flamur Sefaj ka raportuar një herë lidhur me procesin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol dhe Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, lidhur me çështjen e nostrifikimit të diplomave dhe zbatimin e marrëveshjes për njohjen e diplomave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në dy nga mbledhjet e komisioneve ka raportuar edhe shefi i delegacionit të Kosovës për negociatat me Serbinë, Avni Arifi. Komisionet të cilat kanë diskutuar më së shumti temat e

ndërlidhura me dialogun janë Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione. (Shih Tabelën 1.3)

Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike ka trajtuar më së shumti procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Kjo sepse dialogu është pjesë e domenit të politikës së jashtme, si dhe për shkak se me rezolutën e miratuar në Kuvend me 10 mars të vitit 2011 lidhur me dialogun, ky komision ka marrë rol të veçantë në këtë drejtim. Temat më të diskutuara rreth dialogut në këtë komision kanë qenë gjendja e zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese të Brukselit si dhe e ardhmja e dialogut. Gjatë vitit 2018, Komisioni për Punë të Jashtme, në bashkëpunim me KDI-në ka vazhduar organizimin e takimeve koordinuese në mes komisioneve parlamentare. Me 19 mars dhe 21 dhjetor të vitit 2018, është mbajtur takimi i tretë, respektivisht takimi i katërt koordinues në mes Komisioneve, lidhur me rolin monitorues dhe mbikëqyrës të Kuvendit në procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

Edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal i ka kushtuar një vëmendje të veçantë procesit të dialogut. Tema më e diskutuar në këtë komision lidhur me dialogun ka qenë gjendja e zbatimit të Marrëveshjes për Energjinë. Ndër të tjera, me asistencën e KDI-së, ky komision ka ftuar në raportim institucionet e sektorit të energjetikës për të diskutuar rreth zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Gjatë këtij raportimi, komisioni ishte njoftuar se pala kosovare kishte refuzuar propozimin të ENTSO-e, përmes



414

MBLEDHJE TË  
KOMISIONEVE  
PARLAMENTARE

&gt; 23 dëgjime publike

14  
KOMISIONE  
PARLAMENTARE

44

MBLEDHJE ËSHTË  
DISKUTUAR  
PËR DIALOGUN> 13 ka qenë pjesë  
e rendit të ditës

së cilit KOSTT-i do të njihej de facto si bllok i pavarur rregullues, por hidrocentrali i Ujmanit do të vendosej nën kontrollin e Serbisë. KDI i ka dorëzuar këtij komisioni edhe një dokument informues për këtë marrëveshje.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, disa nga komisionet parlamentare të Kuvendit kanë realizuar edhe vizita në terren për të parë nga afër gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit.

**Tabela 1.3:** Diskutimet rreth Dialogut në Komisionet e Kuvendit gjatë vitit 2018 (sesioni pranveror dhe vjeshtor)

Emërtimi i komisionit	Numri i mbledhjeve	Dëgjime Publike	Tema e dialogut si pikë e rendit të ditës	Ngritja e temës së dialogut jashtë rendit të ditës	Diskutime rreth Dialogut në prezencë të ministrave	Raportime të Ministrave për Dialogun
<b>Komisioni për Buxhet dhe Financa</b>	28	1	1	4	1	0
<b>Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim</b>	24	0	0	0	0	0
<b>Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit</b>	38	5	1	1	0	1
<b>Komisioni për Integritet Evropian</b>	22	0	0	2	2	0
<b>Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike</b>	27	0	6	6	4	3





Emërtimi i komisionit	Numri i mbledhjeve	Dëgjime Publike	Tema e dialogut si pikë e rendit të ditës	Ngritja e temës së dialogut jashtë rendit të ditës	Diskutime rreth Dialogut në prezencë të ministrave	Raportime të Ministrave për Dialogun
Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi	48	3	0	2	1	0
Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal	46	3	4	7	2	0
Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor	29	0	0	0	1	0
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	25	2	0	0	0	0
Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	30	3	0	0	0	0
Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës	22	2	1	3	0	0
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	35	3	1	5	2	1
Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	26	1	0	0	0	0
Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë	14					
Takimet koordinuese në mes Komisioneve Parlamentare	2		1			

Gjithsej mbledhje

414

23

14

30

13

5



## KOMISIONET PARLAMENTARE

- Numri i mbledhjeve të komisioneve:	414
- Numri i dëgjimeve publike:	23
- Dialogu si pikë e rendit të ditës:	14
- Dialogu jashtë rendit të ditës:	30
- Raportime të ministrave lidhur me dialogun;:	5
- Diskutime për dialogun në prezencë të ministrave:	13

GJATË VITIT 2018 JANË ZHVILLUAR DY TAKIME KOORDINUESE NË MES TË KOMISIONEVE PARLAMENTARE, RRETH ROLIT MONITORUES DHE MBIKËQYRËS TË KUVENDIT NË PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI. MË 19 MARS, KOMISIONI PËR PUNË TË JASHTME, DIASPORË DHE INVESTIME STRATEGJIKE, NË BASHKËPUNIM ME KDI-NË, KA ORGANIZUAR TAKIMIN E PARË PËR KËTË VIT, PAS DY TAKIMEVE TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2017.

### 3.1 Takimet koordinuese në mes të komisioneve parlamentare

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar dy takime koordinuese në mes të komisioneve parlamentare, rreth rolit monitorues dhe mbikëqyrës të Kuvendit në procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Më 19 mars, Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, në bashkëpunim me KDI-në, ka organizuar takimin e parë për këtë vit, pas dy takimeve të zhvilluara gjatë vitit 2017. Përfaqësuesit e komisioneve, kishin theksuar nevojën për rritje të transparencës dhe përcaktimin e vijave të kuqe të Kosovës në procesin e dialogut. Po ashtu, ishte rekomanduar që të hartohesh një letër e përbashkët e komisioneve drejtuar Qeverisë në lidhje me fazën e re të dialogut, ku kërkohet që Kuvendi të informohet rreth delegacionit shtetëror të Kosovës dhe platformën e re të bisedimeve. Po ashtu, ishte kërkuar iniciimi i një rezolute nga Kuvendi lidhur me fazën e re të dialogut, si dhe krijimi i një komisioni hetimor mbi zbatimin e marrëveshjeve të arritura.<sup>20</sup>

Takimi i dytë koordinues për këtë vit ishte organizuar më 21 dhjetor. Në këtë takim ishte diskutuar rreth sfidave të zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit të cilat ishin evidentuar në raportin e Qeverisë të publikuar në qershor të vitit 2018. Sipas vlerësimit të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, të gjeturat e këtij raporti tregojnë Serbia nuk ka zbatuar gati dy të tretat e marrëveshjeve të arritura deri më tani, për dallim nga pala kosovare e cila ka treguar gatishmëri dhe përkushtim, duke zbatuar pothuajse të gjitha marrëveshjet. Në fund të këtij takimi, përfaqësuesit e komisioneve prezent shprehën zotimin e tyre për vazhdimin e monitorimit të procesit të dialogut sipas fushëveprimeve të komisioneve.<sup>21</sup>

20 Komunikata e KDI-së e datës 19 mars 2018 në, <http://www.votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/180>

21 Komunikata e KDI-së e datës 21 dhjetor 2018, <http://www.votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/269>

### 3.2 Mbikëqyrja në terren e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit

Komisionet parlamentare, gjatë vitit 2018, kanë realizuar dy vizita në terren me asistencë të KDI-së për të monitoruar nga afër gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit. Me 22 mars 2018, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të Kuvendit të Kosovës, ka realizuar një vizitë në KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës). Qëllimi i kësaj vizite ishte informimi i anëtarëve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik lidhur me zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë të arritur mes Kosovës dhe Serbisë, në kuadër të dialogut të Brukselit dhe çështjen e faturimit të energjisë së pjesës veriore të Kosovës.

Gjatë kësaj vizite, anëtarët e komisionit ishin informuar se arsyeja e moszbatimit të marrëveshjes për energji ishte refuzimi i Serbisë që të regjistronte kompaninë e re në Kosovë "Elektro Sever", sipas ligjeve të Republikës së Kosovës. Sipas përfaqësuesve të KOSTT-it, moszbatimi i kësaj marrëveshjeje po i shkaktonte humbje të mëdha financiare Kosovës në përgjithësi, si dhe KOSTT-it në veçanti. Përfaqësuesit e KOSTT-it kishin kërkuar nga deputetët që të ngrisin këtë çështje në Kuvend dhe të kërkonin nga Qeveria që të gjejnë sa më shpejtë një zgjidhje të qëndrueshme. Kjo çështje ishte ngritur në seancat e Kuvendit të datave 16 dhe 26 prill, si dhe 5 qershor të vitit 2018, me ç'rast ishte miratuar edhe një rezolutë e cila kërkonte nga Qeveria që të zgjidhte situatën e krijuar në KOSTT dhe të mos vazhdohej dialogu me Serbinë për çështjet lidhur me energjinë pa u zbatuar marrëveshja ekzistuese.

Me asistencë të KDI-së, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës ka realizuar vizitë në Doganat e Kosovës me 4 dhjetor të vitit 2018. Qëllimi i zhvillimit të këtij takimi ishte informimi nga afër i deputetëve të Kuvendit, mbi sfidat dhe zbatueshmërinë e marrëveshjeve në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, të cilat bien në fushëveprimtarinë e doganave, të tilla si IBM, lëvizja e lirë, vulat doganore, mbledhja e të hyrave doganore, Fondi Zhvillimor për Veriun, si dhe zbatimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për vendosjen e masës mbrojtëse prej 100% ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Nga takimi me drejtorin e Doganave, Bahri Berisha, si dhe zyrtarët tjerë të Doganës, anëtarët e komisionit ishin informuar lidhur me sfidat dhe zbatimin e marrëveshjeve në fjalë.

# REKOMANDIME

BAZUAR NË TË GJETURAT E KËTIJ RAPORTI, INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) OFRON REKOMANDIMET SI NË VIJIM:

1

Kuvendi i Kosovës duhet të jetë aktiv në ushtrimin e mbikëqyrjes efektive të procesit të dialogut Kosovë-Serbi, duke ftuar në raportim të rregullt ekzekutivin, si dhe të gjitha institucionet apo mekanizmat shtetëror të përfshira në procesin e dialogut Kosovë-Serbi;

2

Kuvendi i Kosovës duhet të mbajë diskutime të rregullta lidhur me temat e diskutuara dhe ato të cilat duhet të përfshihen në kuadër të dialogut me Serbinë. Kuvendi i Kosovës duhet të dëshmojë konsistencë duke i trajtuar në vazhdimësi këto çështje mbi bazën e mandatit të tij kushtetues dhe mekanizmave mbikëqyrës që ka në dispozicion;

3

Deputetët e Kuvendit duhet të jenë më aktiv në mbikëqyrjen e procesit të dialogut duke shfrytëzuar mekanizmat që kanë në dispozicion si pyetjet parlamentare, interpelancat, vizitat në terren, debatet parlamentare.

4

Partitë parlamentare duhet të bëjnë përpjekje serioze për tejkalimin e ndasive politike lidhur me procesin e dialogut duke synuar ndërtimin e një qëndrimi unik të Kosovës në këtë proces.

5

Kuvendi i Kosovës duhet të luaj rol pro aktiv në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës, duke synuar bashkërendim ndërinstitucional dhe nxitje të pjesëmarrjes qytetare në këtë proces;

6

Komisionet parlamentare duhet të jenë më efektive në mbikëqyrjen e procesit të dialogut Kosovë-Serbi, duke i dhënë fokus zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri më tani dhe trajtimin e temave që pritet të diskutohen në këtë proces duke ofruar rekomandime konkrete;

7

Komisionet parlamentare duhet të vazhdojnë koordinimin dhe bashkërendimin në mes tyre. Komisionet përkatëse parlamentare, bazuar në fushëveprimtarinë e tyre, me anë të mekanizmave që kanë në dispozicion, duhet të trajtojnë në vazhdimësi çështje/tema specifike lidhur me dialogun, duke ofruar rekomandime konkrete, të cilat duhet të trajtohen në seancat e Kuvendit.

# SHTOJCË


## Puna e komisioneve parlamentare në raport me dialogun

### Komisioni për Buxhet dhe Financa

Komisioni për Buxhet dhe Financa gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 28 mbledhje dhe një dëgjim publik, prej të cilave çështjet lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi i ka ngritur në pesë mbledhje. Temat më të përmendura në këto mbledhje kanë qenë Marrëveshja për Energjinë

dhe çështja e furnizimit të komunave të veriut me energji elektrike,<sup>22</sup> e cila është ngritur në tri nga pesë mbledhjet ku është diskutuar për dialogun. Temat tjera të diskutuara kanë qenë anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar dhe Marrëveshja e Drejtësisë, përkatësisht aspekti financiar i saj. (Shih Tabelën 1.4)

**Tabela 1.4:** Diskutimet rreth Dialogut gjatë vitit 2018 në Komisionin për Buxhet dhe Financa

	REND DITE/DISKUTIM	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
07.02.2018	 <b>Rend Dite</b>	Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të KOSTT SH.A. për vitin 2016; Bisedimet për Energjinë;
28.03.2018	 <b>Diskutim</b>	Marrëveshja e Energjisë;
11.04.2018	 <b>Diskutim</b>	Furnizimi me energji elektrike në Veri; Marrëveshja për energjinë;
16.05.2018	 <b>Diskutim</b>	Anëtarësimi i Kosovës në mekanizma ndërkombëtar;
24.05.2018	 <b>Diskutim</b>	Marrëveshjen e drejtësisë;

22 Gjatë mbledhjes së datës 11 prill të vitit 2018, një nga anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa kishte pyetur përfaqësuesin e Zyrës Rregullative për Energji rreth çështjes e mospagesës së energjisë në veri nga komuniteti serb, si rezultat i së cilës qeveria kishte ndarë 1 milionë euro për KOSTT-in për të mbuluar humbjet. Për më shumë, shih procesverbalin e mbledhjes, i qasshëm në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_04\\_11\\_11\\_7362\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_04_11_11_7362_al.pdf), fq. 4 dhe 5. [Qasur më 22 gusht, 2018]

Megjithatë, çështjet lidhur me dialogun kanë qenë si pikë e rendit të ditës në vetëm një rënë nga mbledhjet e këtij komisioni, kur është bërë shqyrtimi i raportit vjetor financiar të KOSTT-it. Gjatë këtij diskutimi, anëtarët e komisionit kishin kërkuar të dinin nëse përfaqësuesit kishin marrë pjesë në bisedimet në Bruksel për energji, si dhe arsyen pse nuk po realizohej linja e interkoneksionit Kosovë-Shqipëri.<sup>23</sup>

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka qenë i ftuar në një nga mbledhjet ku janë ngritur çështjet lidhur me dialogun, përkatësisht në mbledhjen e datës 28 mars 2018. Në kuadër të raportimit të tij lidhur me shpenzimet e paparashikuara për vitin 2018, ministri Hamza kishte përmendur problemet e KOSTT-it, të lidhura me moszbatimin e Marrëveshjes për Energjinë. Ai kishte deklaruar se Kosova është duke u dëmtuar si rezultat e i moszbatimit të kësaj marrëveshje dhe zgjidhjet që janë bërë nga Qeveria për të mbuluar humbjet janë zgjidhje afatshkurta.<sup>24</sup>

### **Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim**

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 24 mbledhje. Gjatë diskutimeve në këto mbledhje, anëtarët e Komisionit nuk kanë diskutuar rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi pavarësisht faktit që një pjesë e madhe marrëveshjeve të dialogut bien në fushëveprimin e këtij komisioni pasi që marrëveshjet e dialogut kanë të bëjnë, ndër të tjera, edhe me integrimin e komunitetit serb, të drejtat dhe interesat e këtij komuniteti.

### **Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 38 mbledhje dhe pesë dëgjime publike. Çështjet e ndërlidhura me procesin e dialogut Kosovë-Serbi janë diskutuar në dy mbledhje të komisionit, ndërsa në vetëm një prej tyre kjo temë ka qenë e paraparë në rendin e ditës, ku kanë raportuar Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, si dhe kryesuesit e KGJK-së dhe KPK-së. Temë e raportimit ka qenë gjendja në gjykatat në veri të Mitrovicës. Në kuadër të këtij diskutimi, anëtarët e komisionit kishin shprehur shqetësimin e tyre lidhur me gjendjen në veri dhe, siç e kishin quajtur ata, instrumentalizimin e qytetarëve serbë. Me këtë rast, kryetarja e komisionit kishte shprehur shqetësimin e saj që gjykata në veri të vendit ishte jofunksionale që nga vendosja e taksës 100%. Sa i përket këtyre çështjeve, ministri Tahiri kishte raportuar se pas dorëheqjeve të kryetarëve të komunave me shumicë serbe në veri në këtë pjesë të vendit situata ishte e brishtë. Kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, ishte shprehur se do të ftonte në raportim kryetarin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë për tu informuar lidhur me situatën e krijuar. Ndërsa, Bahri Hyseni nga Këshilli Prokurorial kishte deklaruar se nuk ka pasur probleme sa i përket punës së Prokurorisë në Mitrovicë. (Shih Tabelën 1.5)

23 Mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa e datës 7 shkurt, 2018.

E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_02\\_07\\_11\\_7222\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_02_07_11_7222_al.pdf), fq.3. [Qasur më 22 gusht, 2018]

24 Mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, e datës 28 mars, 2018.

E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_03\\_28\\_11\\_7301\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_03_28_11_7301_al.pdf), fq.3. [Qasur më 22 gusht, 2018]



**Tabela 1.4:** Diskutimet rreth Dialogut gjatë vitit 2018 në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit




	REND DITE/DISKUTIM	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
06.03.2018	 <b>Diskutim</b>	Zbatimi i marrëveshjes së Drejtësisë;
04.12.2018	 <b>Rend Dite</b> /  <b>Diskutim</b>	Diskutim lidhur me gjendjen në Gjykatën e Kosovës në veri të Mitrovicës; Të ftuar: Ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahiri, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës z. Nehat Idrizi dhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës z. Blerim Isufaj;

Çështjet lidhur me dialogun janë ngritur para këtij komisioni edhe në mbledhjen e datës 6 mars 2018. Në këtë mbledhje kishte raportuar kryesuesi i KGJK-së, Nehat Idrizi, ku ndër të tjera ishte ngritur edhe çështja e Marrëveshjes së Drejtësisë. Në kuadër të raportimit të tij rreth sistemit gjyqësor, komisioni ishte informuar në lidhje me procesin dhe procedurat e rekrutimit të gjyqtarëve në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Drejtësisë. Gjatë këtij diskutimi, kryetarja e komisionit kishte kërkuar informacione nga kryesuesi lidhur me çështjen e njohjes së gjykimeve të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, që kanë vepruar në kuadrin kushtetues të Serbisë. Ndërsa përgjigja e kryesuesit kishte qenë se do të formohej një komision, për t'i shqyrtuar të gjitha lëndët dhe vendimet që janë nxjerrë nga këto struktura.<sup>25</sup>


### Komisioni për Integritet Evropian

Komisioni për Integritet Evropian gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 22 mbledhje. Në dy nga mbledhjet e mbajtura janë ngritur edhe çështjet e lidhura me procesin e dialogut Kosovë-Serbi, por jo si pika të rendit të ditës. Temat e ndërlidhura me këtë proces kanë qenë zhvillimet në dialog në përgjithësi dhe marrëveshja e drejtësisë. Në të dyja këto mbledhje ka qenë prezente edhe Ministria e Integritet Evropian, Dhurata Hoxha. (Shih Tabelën 1.6)


















**Tabela 1.5:** Diskutimet rreth Dialogut gjatë vitit 2018 në Komisionin për Integritet Evropian

	REND DITE/DISKUTIM	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
02.02.2018	 <b>Diskutim</b>	Dialogu me Serbinë në përgjithësi;
19.04.2018	 <b>Diskutim</b>	Dialogu në përgjithësi; Integritet i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin e drejtësisë;

25 Mbledhja e Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e datës 6 mars 2018. E qasshme në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_03\\_06\\_11\\_7275\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_03_06_11_7275_al.pdf)



**Tabela 1.7:** Diskutimet rreth Dialogut gjatë vitit 2018 në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

	REND DITE/DISKUTIM	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
26.01.2018	 <b>Diskutim</b>	Shqyrtimi i draft-Planit dhe Programit të punës së komisionit për vitin 2018 (propozimet e KDI-së rreth dialogut); Propozim për të ftuar në raportim kryenegociatorin, z. Avni Arifi; Plani për takimin e përbashkët të komisioneve parlamentare, lidhur me dialogun;
30.01.2018	 <b>Diskutim</b>	Lobimi i Serbisë kundër Kosovës;
31.01.2018	 <b>Rend Dite</b> /  <b>Diskutim</b>	Raportim i z.Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër dhe ministër i MPJ-së, lidhur me lobimin e Serbisë kundër Kosovës;
09.02.2018	 <b>Diskutim</b>	"Lidhur me ftesën për raportim të z.Avni Arifi, shef i negociatave me Serbinë që të raportojë lidhur me platformën e dialogut; Ftesa për raportim me 27 shkurt 2018 e z. Flamur Sefaj, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të raportuar lidhur me procesin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol. Udhëheqja nga Komisioni për Punë të Jashtme i koordinimit me komisionet e tjera lidhur me monitorimin e dialogut, bashkë me KDI-në;"
20.02.2018	 <b>Rend Dite</b> /  <b>Diskutim</b>	Raportim i shefit të negociatave me Serbinë, z. Avni Arifi lidhur me platformën e Qeverisë për dialogun;
27.02.2018	 <b>Rend Dite</b> /  <b>Diskutim</b>	Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme z. Flamur Sefaj, lidhur me procesin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol/ Marrëveshja për përfaqësim dhe antarësim të Kosovës në organizata;
29.03.2018	 <b>Rend Dite</b> /  <b>Diskutim</b>	Raportim i shefit të negociatave me Serbinë z. Avni Arifi lidhur me bisedimet Kosovë -Serbi;
12.04.2018	 <b>Diskutim</b>	Pengimi i Serbisë ndaj njohjeve të Kosovës;
04.05.2018	 <b>Rend Dite</b>	Shqyrtimi i Projekt Platformës shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve;
12.06.2018	 <b>Diskutim</b>	Tërheqja e njohjeve nga Serbia;
17.10.2018	 <b>Rend Dite</b>	Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë për dialogun;
19.12.2018	 <b>Diskutim</b>	Raportim i fundvitit i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme z. Behgjet Pacollit, lidhur me fushëveprimtarinë e MPJ-së/ Lobimi i Serbisë kundër Kosovës;





Në mbledhjen e 2 shkurtit, tema e dialogut është ngritur në kuadër të diskutimit lidhur me Strategjinë e Zgjerimit të BE-së për shtetet e Ballkanit Perëndimor, për të cilën ka raportuar ministria Hoxha. Anëtarët e komisionit kishin shprehur shqetësimin e tyre lidhur me qasjen, sipas tyre, të padrejtë të BE-së ndaj Kosovës në krahasim me Serbinë, duke konsideruar se në procesin e integritit Serbia ishte favorizuar më shumë se Kosova, ndonëse ajo kishte qenë më destruktive në raport me Kosovën sa i përket përbushjes së obligimeve të agjendave të BE-së.<sup>26</sup>

Ndërsa, ministria Hoxha kishte sqaruar para anëtarëve të komisionit se Kosovës dhe Serbisë i kërkohej të arrinin një marrëveshje ligjërish të obligueshme përfundimtare për të avancuar në procesin e integritit. Ajo kishte theksuar para komisionit edhe pritjet dhe kërkesat e Kosovës nga faza e re e dialogut Kosovë-Serbi, që dialogu të ishte më i strukturuar, transparent dhe më i avancuar. Ky dialog po ashtu duhet të kishte një datë të përfundimit dhe të përcaktohej qëllimi i tij i saktë, që duhej të ishte njohja reciproke.<sup>27</sup>

Mbledhja tjetër e komisionit në të cilën është ngritur çështja e dialogut ka qenë ajo e datës 19 prill 2018. Sërish kjo çështje ishte ngritur në kuadër të raportimit të Ministres së Integritit Evropian, Dhurata Hoxha, lidhur me Raportin për Kosovën të vitit 2018.<sup>28</sup> Gjatë këtij diskutimi, ministria Hoxha i kishte informuar anëtarët e komisionit se në këtë raport ishte vlerësuar pozitivisht angazhimi i Kosovës në kuadër të dialogut me Serbinë. Po ashtu, pozitivisht ishte vlerësuar edhe integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin e drejtësisë, si pjesë e zbatimit të Marrëveshjes për Drejtësinë, e arritur në kuadër të dialogut.<sup>29</sup>

## Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Komisioni parlamentar që e ka shqyrtuar më së shumti çështjen e dialogut Kosovë-Serbi është Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, duke qenë se çështja e dialogut bie në fushëveprimin e këtij komisioni në kuadër të politikës së jashtme, por edhe sipas rezolutës së Kuvendit për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë e miratuar nga më 10 mars 2011. Pika 6 e kësaj rezolute parasheh që, i/e emëruari nga Kryeministri udhëheqës i delegacionit të Kosovës për dialogun me Serbinë ndër të tjera do të informojë në baza të rregullta Komisionin për Politikë të Jashtme.<sup>30</sup>

Ky Komision ka diskutuar lidhur me këtë temë në 12 nga 27 mbledhjet e mbajtura, ndërsa në gjashtë nga mbledhjet kjo temë ka qenë e përcaktuar edhe në rendin e ditës. (Shih Tabelën 1.7)

Temat më të diskutuara gjatë këtyre mbledhjeve kanë qenë zbatimi i marrëveshjeve dhe e ardhmja e procesit të dialogut. Ndër të tjera, komisioni ka diskutuar lidhur me lobimin e Serbisë kundër Kosovës, dhe lajmet për tërheqjen e njohjeve të Kosovës nga shtetet e ndryshme si rezultat i këtij lobimi. Temat e tjera të diskutuara kanë qenë vijat e kuqe të Kosovës në dialog, riformatimi i dialogut, si dhe marrëveshja për përfaqësim dhe anëtarësim të Kosovës në organizata rajonale.

Komisioni kishte diskutuar edhe lidhur me platformën e Qeverisë Kosovës për dialogun, në mbledhjen e datës 4 maj 2018.<sup>31</sup> Pas diskutimeve, komisioni nuk e kishte aprovuar platformën dhe i kishte rekomanduar Kuvendit që mos t'a miratojë platformën

26 Mbledhja e Komisionit për Integritim Evropian, e datës 2 shkurt, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_02\\_02\\_11\\_7215\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_02_02_11_7215_al.pdf), fq. 3. [Qasur më 23 gusht, 2018]

27 Po aty, fq.5.

28 Raporti i plotë i qasshëm në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

29 Mbledhja e Komisionit për Integritim Evropian, e datës 19 prill, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_04\\_19\\_14\\_7380\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_04_19_14_7380_al.pdf), fq.2. [Qasur më 23 gusht, 2018]

30 Shih Rezolutën për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të datës 10 mars 2011 në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta\\_per\\_dialogun\\_midis\\_R.Kosoves\\_dhe\\_R.Serbise\\_2.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_dialogun_midis_R.Kosoves_dhe_R.Serbise_2.pdf)

31 Seanca për diskutimin e kësaj platforme ishte organizuar me datën 5 qershor 2018, por para diskutimit, Qeveria kishte tërhequr platformën për dialogun me arsyetimin për t'i dhënë kohë dhe hapësirë ndërtimit të një konsensusi sa më të gjerë nacional dhe vazhdimin të konsultimeve të mëtejshme. Kishte qenë Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Skender Reçica që kishte dalë në foltoren e Kuvendit për të njoftuar tërheqjen e këtij dokumenti nga shqyrtimi në Kuvend. Shih seancën e Kuvendit me pikë të rendit të ditës Shqyrtimin i Projekt-platformës shtetërore për finalizimin e dialogut. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans\\_s\\_2018\\_06\\_05\\_11\\_7463\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2018_06_05_11_7463_al.pdf), fq.36. [Qasur më 25 gusht, 2018]



me përmbajtjen e propozuar nga Qeveria. Po ashtu, Kryesisë së Kuvendit i ishte rekomanduar që t'a organizojë një debat parlamentar nga i cili do të dilnin rekomandimet për ndërtimin e platformës konsensuale shtetërore të Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë.<sup>32</sup>

Në një nga mbledhjet ku është diskutuar çështja e dialogut, ka raportuar Ministri i asokohshëm i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, lidhur me procesin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol. Gjatë kësaj mbledhje ministri i kishte informuar anëtarët e komisionit se ishin duke punuar për lobim për anëtarësim në Interpol, por se kishte edhe lobime të kundërta nga Serbia dhe Rusia.<sup>33</sup> Anëtarët e komisionit e kishin ndërlidhur tërheqjen e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol me procesin e dialogut Kosovë-Serbi<sup>34</sup>, por ministri Sefaj kishte mohuar një ndërlidhje të tillë.<sup>35</sup>

Para komisionit kishte raportuar dy herë edhe Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. Në mbledhjen e datës 31 janar 2018 ai ishte ftuar nga komisioni për të diskutuar, ndër të tjera, lidhur me fushatën nga ana e Serbisë në raport me disa shtete, për t'i bindur ato për tërheqjen e njohjeve të Kosovës. Lidhur me këtë, ministri Pacolli i kishte njoftuar deputetët se Serbia kishte siguruar një buxhet prej 300 milionë euro dhe një ekip prej 20 ekspertësh që të vizitojnë shtetet e ndryshme të botës për të lobuar kundër Kosovës.<sup>36</sup> Ministri Pacolli, kishte përmendur këtë çështje edhe gjatë raportimit të tij në mbledhjen e datës 12 qershor 2018.<sup>37</sup>

Përveç ministrave, para komisionit ka raportuar dy herë edhe shefi i negociatave me Serbinë, Avni Arifi<sup>38</sup>, pas zhvillimit të takimeve në kuadër të bisedimeve teknike Kosovë-Serbi.<sup>39</sup> Gjatë raportimit të tij me datën 20 shkurt, Arifi i kishte informuar anëtarët e komisionit se po synohej që procesi i negociatave të ishte sa më gjithëpërfshirës dhe i kishte ftuar partitë parlamentare që ta kenë një përfaqësues në ekipin negociator. Ai po ashtu kishte njoftuar komisionin në lidhje me takimet që do të mbaheshin me palën serbe gjatë fundit të muajit ku do të bisedohej për ngecjet në zbatimin e implementimit e marrëveshjeve ekzistuese.<sup>40</sup>

Arifi kishte raportuar sërish edhe në mbledhjen e datës 29 mars, pas tri takimeve të mbajtura në Bruksel në kuadër të dialogut teknik. Ai njoftoi anëtarët e komisionit se në këto takime ishte diskutuar lidhur me zbatimin e marrëveshjeve për lirinë e lëvizjes, për energji dhe për drejtësi. Sipas tij, delegacioni serb kishte qenë i interesuar të diskutojë vetëm për asociacionin dhe jo për tema tjera dhe se në komunikimet e Serbisë me BE-në ajo fajësonte tërësisht Kosovën për mos zbatimin e marrëveshjeve të dialogut.

Me 17 tetor, ky komision ka diskutuar edhe për Raportin e Qeverisë mbi arritjet dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit. Anëtarët e Komisionit kishin shprehur shqetësimet e tyre lidhur me mungesën e zbatimit të marrëveshjeve të dialogut.<sup>41</sup> Në fund të diskutimit, komisioni kishte propozuar që të hartohej një raport me rekomandime, pas analizës

32 Mbledhja e Komisionit për Punët të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, e datës 4 maj, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_05\\_04\\_14\\_7396\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_05_04_14_7396_al.pdf) [Qasur më 25 gusht, 2018]

33 Mbledhja e Komisionit për Punët të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, e datës 27 shkurt, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_02\\_27\\_13\\_7261\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_02_27_13_7261_al.pdf), fq.2. [Qasur më 25 gusht, 2018]

34 Po aty, fq. 4.

35 Po aty, fq. 5.

36 Mbledhja e Komisionit për Punët të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, e datës 31 janar, 2018. E qasshme në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_01\\_31\\_10\\_7213\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_01_31_10_7213_al.pdf), fq. 2. [Qasur më 27 gusht, 2018]

37 Mbledhja e Komisionit për Punët të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, e datës 12 qershor, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_06\\_12\\_13\\_7476\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_06_12_13_7476_al.pdf) [Qasur më 27 gusht, 2018]

38 Z. Avni Arifi ishte emëruar shef i negociatave me Serbinë në mbledhjen e Qeverisë së datës 12 janar, 2018. Për më shumë, shih Vendimin nr. 12/24 në, [http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_s%C3%AB\\_24-t%C3%AB\\_t%C3%AB\\_Qeveris%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Republik%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Kosov%C3%ABs\\_2018.pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_s%C3%AB_24-t%C3%AB_t%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2018.pdf) [Qasur më 1 shtator, 2018]

39 Z. Avni Arifi ka raportuar në mbledhjen e datës 20 shkurt dhe në mbledhjen e datës 29 mars, 2018. Procesverbalet e mbledhjeve janë të qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_02\\_20\\_13\\_7245\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_02_20_13_7245_al.pdf); dhe [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_03\\_29\\_14\\_7328\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_03_29_14_7328_al.pdf) [Qasur më 27 gusht, 2018]

40 Shih mbledhjen e Komisionit për Punët të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, e datës 20 shkurt, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_02\\_20\\_13\\_7245\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_02_20_13_7245_al.pdf) [Qasur më 1 shtator, 2018]

41 Shih mbledhjen e Komisionit për Punët të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, e datës 17 tetor, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_10\\_17\\_13\\_7657\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_10_17_13_7657_al.pdf) [Qasur më 29 dhjetor, 2018]



së detajuar të procesit të dialogut dhe marrëveshjeve të arritura gjatë shtatë viteve të dialogut. Mirëpo në mungesë të kuorumit ky propozim nuk ishte miratuar.

### **Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi**




Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 48 mbledhje dhe tri dëgjime publike. Çështjet lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi janë ngritur në vetëm dy mbledhje të këtij komisioni, përkatësisht atë të datës 19 janar dhe 12 tetor të vitit 2018. (Shih Tabelën 1.8)

Në njërën nga mbledhjet ishte ngritur çështja e teksteve shkollore për serbët në Kosovë dhe shqiptarët në Luginën e Preshevës. Një nga anëtarët e komisionit, kishte ngritur

çështjen e teksteve mësimore duke e konsideruar se ato kishin përmbajtje antikushtetuese, në të cilat Kosova cilësohej si pjesë e Serbisë. Sipas tyre, kështu kishte konstatuar edhe një komision i formuar për vlerësim të teksteve por asgjë nuk ishte ndërmarrë nga të gjeturat e tij.<sup>42</sup>

Ndërsa në mbledhjen tjetër ishte ngritur çështja e planprogrameve të Serbisë me të cilat zhvillohet procesi mësimor për komunitetin serb në Kosovë. Me këtë rast, një nga anëtarët e komisionit kishte kërkuar të dinte se çfarë kishte bërë MASHT-i për t'i hequr nga përdorimi planprogramet e Serbisë, që sipas tij nxisin urrejtje ndëretnike.<sup>43</sup> Ministri i Arsimit, i cili ishte duke raportuar në mbledhje, ishte përgjigjur se kjo çështje nuk do të ndryshonte pa u zgjidhur problemi politik në komunat me shumicë serbe, në të cilat MASHT nuk kishte akoma qasje. Ai kishte shtuar se MASHT-i ka në plan krijimin e një komisioni për zgjidhjen e këtij problemi.

**Tabela 1.8:** Diskutimet rreth Dialogut gjatë vitit 2018 në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion Dhe Ndërmarrësi

	REND DITE/DISKUTIM	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
19.01.2018	 <b>Diskutim</b>	Tekstet shkollore për serbët në Kosovë dhe shqiptarët në Luginën e Preshevës
12.10.2018	 <b>Diskutim</b>	Lidhur me plan-programet e Serbisë, me të cilat mësojnë minoritetet në Kosovë

42 Mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, e datës 19 janar, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_01\\_19\\_10\\_7174\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_01_19_10_7174_al.pdf) [Qasur më 27 gusht, 2018]

43 Mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, e datës 12 tetor, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_10\\_12\\_13\\_7640\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_10_12_13_7640_al.pdf) [Qasur më 29 dhjetor, 2018]
















## Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 46 mbledhje

dhe tri dëgjime publike. Çështjet e ndërlidhura me procesin e dialogut ky Komision i ka diskutuar në 11 nga këto mbledhje, ndërsa në katër nga mbledhjet e mbajtura, çështjet e dialogut kanë qenë të parapara edhe në rendin e ditës. (Shih Tabelën 1.9)

**Tabela 1.9:** Diskutimet rreth Dialogut gjatë vitit 2018 në Komisioni Për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri Dhe Zhvillim Rajonal

 REND DITE/DISKUTIM	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
19.03.2018  <b>Diskutim</b>	Njoftim i kryetarës për një vizitë në KOSST, me iniciativën e KDI-së;
27.03.2018  <b>Diskutim</b>	Njoftim i kryetarës pas realizimit të vizitës në KOSTT, me iniciativën e KDI-së;
29.03.2018  <b>Rend Dite</b>	Raportim i institucioneve përkatëse për fushën e energjisë, të ftuar përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KOSTT-it;
12.04.2018  <b>Diskutim</b>	Problemet e KOSTT-it;
12.06.2018  <b>Diskutim</b>	Marrëveshja për Energji;
10.07.2018  <b>Diskutim</b>	Marrëveshja për Energji;
17.07.2018  <b>Diskutim</b>	Lidhur me ndërprerjen e sinjalit e të gjithë operatorëve të palicencuar të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe veriun e vendit;
20.11.2018  <b>Diskutim</b>	Kryetarja kërkoi nga anëtarët e komisionit, që të vizitohet KOSTT-i, në mënyrë që të marrin informacionet e sakta për situatën aktuale rreth anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E. (Me rekomandim të KDI-së) ;
22.11.2018  <b>Rend Dite</b>	Kryetarja propozoi që më 26.11.2018 të ftohen në takim institucionet që janë të përfshira në procesin e anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E, siç janë ministria e zhvillimit ekonomik, KOSTT-i, ZRRE-ja dhe përfaqësuesi i kryeministrit. (Me rekomandim të KDI-së);
26.11.2018  <b>Rend Dite</b> /  <b>Raportim</b>	Raportim i përfaqësuesve të institucioneve ligj zbatuese lidhur me procesin e anëtarësimit të NP KOSTT në ENTSO-E; - Te ftuar: Lulzim Demolli, Luan Morina – MZHE, Halit Hoxha – MZHE, Ilir Shala, Kadri Kadriu – KOSTT, Arsim Janova – ZRRE;
10.12.2018  <b>Diskutim</b>	Shkëmbimi i mallrave me Serbinë;

Tema më e diskutuar rreth dialogut në këtë komision ka qenë Marrëveshja për Energjinë. Komisioni ka diskutuar edhe lidhur me planifikimin dhe realizimin e një vizite në KOSTT, me iniciativën e KDI-së. Çështje tjera të diskutuara gjatë këtyre mbledhjeve kanë qenë problemet e KOSTT-it si pasojë e mos zbatimit të Marrëveshjes për Energjinë, si dhe taksa prej 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Në dy nga mbledhjet kur është ngritur çështja e dialogut ka qenë prezent edhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka.

Me 22 mars, KDI në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me Kuvendin e Kosovës kishte realizuar një vizitë në KOSTT me anëtarët e këtij komisioni. Qëllimi i kësaj vizite kishte qenë informimi i anëtarëve të komisionit lidhur me zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë, të arritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, si dhe faturimin të energjisë së pjesës veriore të Kosovës.<sup>44</sup>

Pas kësaj vizite, më 29 mars, komisioni kishte ftuar në raportim përfaqësuesit e ZRRE-së dhe KOSTT-it. Anëtarët e komisionit kishin kërkuar nga përfaqësuesit e ftuar sqarime lidhur me progresin, ngeçjet dhe pengesat në zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë, si dhe të sqaronin se pse Qeveria kishte ndarë një milion euro për KOSTT-in.<sup>45</sup> Përfaqësuesit e KOSTT-it i kishin informuar anëtarët e komisionit se problemet e KOSTT-it kishin ardhur për shkak të kësaj çështje si dhe për shkak të moszbatimit të marrëveshjes për energji nga ana e Serbisë.<sup>46</sup>

Me 26 nëntor, komisioni, me rekomandim të KDI-së, kishte ftuar në raportim institucionet e përfshira në procesin e anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E, përkatësisht Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, KOSTT-in, ZRRE-në dhe përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit. Qëllimi i këtij takimi ishte informimi

i komisionit në lidhje me gjendjen në sektorin energjetik, anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E, shpenzimet e energjisë në komunat veriore si dhe zbatimi i Marrëveshjes për Energjinë.<sup>47</sup> Me këtë rast përfaqësuesit e institucioneve të energjisë kishin informuar anëtarët e komisionit lidhur me sfidat e zbatimit të marrëveshjes së energjisë dhe vështirësitë me të cilat përballej KOSTT-i si pasojë e moszbatimit të kësaj marrëveshjeje.

### **Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 29 mbledhje. Ky komision ka ngritur për diskutim vetëm një herë çështjen e dialogut Kosovë-Serbi, përkatësisht Fondin Zhvillimor për Veriun.

Në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik, në të cilën ka qenë i ftuar në raportim Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikallo, një nga anëtarët e komisionit shprehu interesim lidhur me këtë Fondin Zhvillimor, që përfshin katër komunat veriore, për të cilin deklaroi se ka dyshime se është ndarë në baza etnike. Për këtë çështje, ministri nuk kishte ofruar përgjigje.<sup>48</sup>

### **Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 25 mbledhje dhe dy dëgjime publike. Çështjet lidhur me procesin e dialogut janë ngritur në një mbledhje të komisionit, por vetëm si diskutim dhe jo si pikë e rendit të ditës.

44 Për më shumë, shih detajet e kësaj vizite në: <http://www.votaimo.org/Public/DialogActivity/Detail/177>

45 Qeveria e Kosovës me datën 5 mars 2018 kishte marrë vendim për të ndarë 1 milionë euro për KOSTT-in, për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave veriore të Kosovës. Ky vendim kishte ardhur pas vendimit të Gjykatës së Apelit se ZRRE-ja nuk kishte të drejtë të faturonte qytetarët e tjerë të Kosovës për energjinë e elektrike të shpenzuar në këto komuna.

46 Mbledhja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e datës 29 mars, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_03\\_29\\_10\\_7329\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_03_29_10_7329_al.pdf) [Qasur më 01 shtator, 2018]

47 Mbledhja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e datës 26 nëntor, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_11\\_26\\_12\\_7741\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_11_26_12_7741_al.pdf) [Qasur më 29 dhjetor, 2018]

48 Mbledhja e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, e datës 10 korrik, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_07\\_10\\_11\\_7526\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_07_10_11_7526_al.pdf) [Qasur më 01 shtator, 2018]

Në mbledhjen e datës 18 prill, ky komision ka diskutuar lidhur me parregullsitë e produkteve medicinale që po qarkullonin nga Serbia në drejtim të Kosovës<sup>49</sup>, me ç'rast kishte raportuar kryeshefi i Agjencisë për Produkte dhe Pajisje Medicinale<sup>50</sup>. Komisioni kishte kërkuar nga kryeshefi informacion lidhur me lajmin për kontrabandimin dhe parregullsitë e mëdha të produkteve medicinale, ndër to edhe produkte fallco dhe pa banderola, që po qarkullonin nga Serbia në drejtim të Kosovës. Kryeshefi kishte potencuar që kontrabandimi i mallrave ishte pjesë e përgjegjësisë së Inspektoratit dhe e Doganës. Anëtarët e komisionit kishin shprehur përkrahjen e tyre për të adresuar kërkesat e tyre tek Ministria e Shëndetësisë, ndër to edhe për këtë çështje.<sup>51</sup>

### Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media






Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 30 mbledhje dhe

tri dëgjime publike. Mirëpo gjatë tyre ky Komision nuk ka ngritur çështjet e lidhura me procesin e Dialogut Kosovë-Serbi. Kjo pavarësisht faktit se një numër i marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut bie në fushëveprimin e këtij Komisioni ndër të tjera edhe Marrëveshja për Regjistrat Civil, Regjistrat Kadastral dhe Marrëveshja e Drejtësisë.

### Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 22 mbledhje dhe dy dëgjime publike. Çështjet e ndërlidhura me procesin e dialogut Kosovë-Serbi ky komision i ka diskutuar në katër nga mbledhjet e mbajtura, ndonëse këto tema nuk kanë qenë të përcaktuara në rendin e ditës. (Shih Tabelën 1.10)

**Tabela 1.10:** Diskutimet rreth Dialogut gjatë vitit 2018 në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

	REND DITE/DISKUTIM	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
06.02.2018	 <b>Diskutim</b>	Rëndësia e vazhdimit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë;
27.03.2018	 <b>Diskutim</b>	Ndalimi i hyrjes së zyrtarëve të shtetit serb në Kosovë;
29.03.2018	 <b>Diskutim</b>	Lidhur me zhvillimet e fundit në pjesën veriore të Mitrovicës, me theks të veçantë për arrestimin e zyrtarit të lartë të shtetit serb, Marko Gjuriq;
04.05.2018	 <b>Diskutim</b>	Zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit;

49 Mbledhja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e datës 18 prill, 2018. E qasshme në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_04\\_18\\_10\\_7370\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_04_18_10_7370_al.pdf) [Qasur më 1 shtator, 2018]

50 Ky raportim ishte zhvilluar pas takimit koordinues të komisioneve parlamentare, lidhur me monitorimin dhe mbikëqyrjen e procesit të dialogut Kosovë-Serbi, që si aktivitetet është mbështetur nga KDI.

51 Po aty.











Temat lidhur me dialogun që janë ngritur në mbledhjet e këtij komisioni kanë qenë rëndësia e vazhdimit të dialogut dhe zbatimi i marrëveshjeve të arritura në Bruksel.<sup>52</sup> Tema më e diskutuar ka qenë ndalimi i hyrjes së zyrtarëve të shtetit serb në Kosovë dhe arrestimi i zyrtarit të lartë të Qeverisë së Serbisë, Marko Gjuriq, çështje kjo e cila është diskutuar në dy mbledhje. Sipas Drejtorit të asokohshëm të Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, arrestimi i Gjuriqit kishte ndodhur pas mosrespektimit të vendimit të Qeverisë për ndalimin e hyrjes së tij në Kosovë. Lidhur me këtë çështje kishte mospajtime në mes të anëtarëve të komisionit. Anëtarët shqiptarë të komisionit vlerësonin se operacioni për ndalimin e Gjuriqit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, si dhe ishte realizuar në mënyrë të rregullt nga Policia, ndërsa anëtarët nga komuniteti serb mendonin se ishte përdorur forcë të tepruar gjatë realizimit të operacionit.<sup>53</sup>

## Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione


Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka mbajtur gjithsej 35 mbledhje gjatë vitit 2018, prej të cilave procesi i dialogut është diskutuar në shtatë mbledhje, ndërsa në dy mbledhje kjo çështje ka qenë në rend të ditës. Çështja më e diskutuar ka qenë ajo e personave të pagjetur, të cilën komisioni e ka trajtuar në gjashtë mbledhje. Në tri prej tyre kanë qenë prezent edhe anëtarë të ekzekutivit. (Shih Tabelën 1.11)

**Tabela 1.11:** Diskutimet rreth Dialogut gjatë vitit 2018 në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

	REND DITE/DISKUTIM	ÇËSHTJA E DISKUTIMIT
22.01.2018	 <b>Diskutim</b>	Personat e zhdukur;
07.02.2018	 <b>Rend Dite</b> /  <b>Raportim</b>	Raportimi i ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Shyqeri Bytyqi, lidhur me çështjen e nostrifikimit të diplomave dhe zbatimin (mos zbatimin) Marrëveshjes për njohjen e diplomave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
14.02.2018	 <b>Diskutim</b>	Personat e zhdukur;
09.03.2018	 <b>Diskutim</b>	Personat e zhdukur;
06.06.2018	 <b>Diskutim</b>	Personat e pagjetur; Përfaqësimi ndërkombëtar i Kosovës dhe pengesat nga Serbia;
20.07.2018	 <b>Diskutim</b>	Diskutim lidhur me çështjen e Personave të Pagjetur pas samitit të mbajtur në Londër;

52 Lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit në faqen elektronike të Kuvendit të Kosovës nuk janë dhënë informacione se çfarë ka raportuar ministri lidhur me këtë çështje.

53 Mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e datës 29 mars, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_03\\_29\\_11\\_7333\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_03_29_11_7333_al.pdf) [Qasur më 01 shtator, 2018]



Gjatë këtyre diskutimeve anëtarët e komisionit kanë ngritur çështjen e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit për personat e zhdukur dhe beneficinet e familjarëve. Po ashtu, në mbledhjen e datës 6 qershor, ishte prezantuar Plani i Përbashkët i Punës së Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur. Gjatë këtij diskutimi, me anëtarët e Komisionit të Qeverisë ishte shtruar mundësia që në platformën e dialogut të përfshihej çështja e personave të zhdukur.<sup>54</sup>

Në mbledhjen e datës 7 shkurt, kishte raportuar edhe Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, lidhur me çështjen e nostrifikimit të diplomave dhe çështjen e gjendjes së zbatimit të Marrëveshjes për Njohjen e Diplomave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.<sup>55</sup> Komisioni kishte kërkuar nga ministri të paraqesë arsyet se pse kjo marrëveshje nuk po zbatohet, si dhe kishin përmendur sfidat e nostrifikimit të diplomave nga ana e qytetarëve të Kosovës. Përgjigja e ministrit kishte qenë se mos zbatimi i marrëveshjes ishte problem politik.

## Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 26 mbledhje. Çështjet e ndërlidhura me dialogun janë ngritur në vetëm një mbledhje të këtij komisioni, përkatësisht atë të datës 5 tetor. Në këtë mbledhje ishte diskutuar lidhur me punësimin e zyrtarëve të komunitetit serb në institucione, për të cilët anëtarët e komisionit kishin shprehur shqetësimin e tyre se nuk po respektonin orarin e punës. Në këtë drejtim, komisioni kishte nxjerrë një përfundim, që Ministria e Infrastrukturës duhet të dorëzojë raport me shkrim, lidhur me numrin e të punësuarve të minoritetit serb, si dhe numrin e atyre që nuk kishin respektuar orarin e punës, të përcaktuara me rregullat e shërbimit civil.

## Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej gjashtë mbledhje. Nuk dihet nëse ky komision në ndonjë nga mbledhjet e tij ka ngritur çështje të ndërlidhura me dialogun, pasi që mbledhjet e tij janë të mbyllura për publikun.

54 Mbledhja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione, e datës 6 qershor, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_06\\_06\\_10\\_7451\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_06_06_10_7451_al.pdf) [Qasur më 01 shtator, 2018]

55 Mbledhja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione, e datës 7 shkurt, 2018. E qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2018\\_02\\_07\\_11\\_7227\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2018_02_07_11_7227_al.pdf) [Qasur më 01 shtator, 2018]



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Federal Department of Foreign Affairs FDFA**